



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI

3732
Nr. ___ prot

Date 27 / 11 / 2025

P/VENDIM
Nr. 38 datë. 27 / 11 / 2025

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fushë-Arrëz, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Sadri Dervishi lagjia Trun i poshtem fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, nga buxheti i bashkise, programi "Emergjencat Civile".

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" Ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", Ligjit nr. 8756 datë 23.03.2001 "Për Emergjencat Civile", të ndryshuar, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kreu III¹, si dhe në Vertetimin e leshuar nga MNZ Fushë-Arrëz me datë 21.11.2025 mbi djegien e banesës së shtetasit **Sadri Dervishi**:
Spektori i Emergjencave Civile, Finances dhe Kryetari i Bashkisë,

Propozojnë:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Fushë-Arrëz për mbështetjen financiare të shtetasit **Sadri Dervishi** për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025 me vlere demesh te preventivit strukturor ne vleren e **2 452 713** leke dhe preventivit te mobiljeve ne vlere **310500** leke me vlerre totale demi **2 763 213** leke.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga bashkia Fushë-Arrëz per familjen e demtuara .
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Z. **Sadri Dervishi** agjia Trun i Poshtem fshati Sakat, Njësia Administrative Blerim ndihmen emergjente në vleren prej **50 000** (pesëdhjete mijë) lekë nga buxheti i bashkisë Fushë-Arrëz, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga këshilli i bashkisë për vitin **2025**
4. Ndhma financiare për familjet e shtetasve **Sadri Dervishi**, te përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 dhe . ligjin Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile"
5. Për shpërblimin e demit të përdoret fondi i Emergjencave Civile i cili sistemohet në paksim nga Gr.00, Tit 03280, Kap 01, Art 609.1009 dhe ne shtesë Gr.00, Tit 03280, 606 0099.
6. Ndhma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së sipër cituara, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri i rënë me datë **14.11.2025**.

Përgj i Sektorit të Emergjencave Civile

Përgj i Sektorit të Finances

Dod PEPA

Flora BARDHOKU

KRYETARI

Hil CURRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
DREJTORIA E URBANISTIKES DHE KONTROLLIT TE TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Lenda: Relacion Shpjegues

Drejtuar: Keshillit te Bashkisë

Me datën 14.11.2025 kemi pasur djegien e banesës së familjes së Sadri Dervishi lagjia Trun i Poshtem fshati Sakat Njesia Administrative Blerim me 10 anëtar dhe dy kurore (familje) . Bashkia me të marrë informacionin ka bërë ngritjen e grupit të punës për verifikimin e dëmëve të shkaktëtura nga zjarri i rënë me datë 14.11.2025, ku pas konstatimit të dëmit janë bërë verifikimet përkatëse duke u shënuar të gjitha në procesverbalet e konstatimit dhe më pas duke hartuar preventivin e dëmit nga ana strukturore (ndërtimore) në vleren prej **2 452 713** lekë dhe preventivin e mobiljeve në vlerën **310 500** lekë me vlere totale dëmi **2 763 213** leke, ku sipas VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 pika 3 paragrafi ç, masa e ndihmes financiare do të jetë 50% e vleres së dëmit të përlogaritur dhe konkretisht **1 381 606** leke.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

PËRGJEGJESI I SEKTORIT

EMERGJENCAVE CIVILE

Ing. Dod PEPA